



KOMUNIKATË PËR SHYTP

«Pajtimi për të ardhmen»

www.reconcilingforthefuture.org

www.see-future.org

Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore, kumton fillimin e programit më të ri të quajtur **“Pajtimi për të ardhmen”**. Programi është i sponsoruar nga presidenca Greke e Bashkimit Evropian dhe në Bashkëpunim me Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Gjithashtu, ky program përkrahet edhe nga Ministrinë e jashtme të Greqisë, Norvegjisë dhe Suedisë.

Gjatë fazës së parë të këtij programi, i cili filloi më 20 janar, u formua platforma e dialogut elektronik në adresën www.reconcilingforthefuture.org. Ky forum, tashmë tërhoqi më se 150 pjesmarrës të regjistruar, dhe i njëjti përfshinë platformën për diskutime rreth prospekteve dhe problemeve që kanë të bëjnë me Ballkanin, diskutime këto, që zhvillohen nga qytetarët e Evropës Juglindore.

Rezultatet e forumit **“Pajtimi për të ardhmen”** do të komunikohen gjatë konferencës e cila do të organizohet në fillim të muajit prill në Selanik. Në këtë konferencë do të marrin pjesë personalitete nga vendet e Ballkanit, nga Bashkimi Evropian dhe perfaqësuesit e Organizatave Ndërkombëtare si dhe atyre Joqeveritare, përfshirë këtu edhe grupet e të rinjëve.

Ky program ka gjithashtu për qëllim që të promovojë parimet themelore të bashkëpunimit rajonal, dhe duhet të parashtrijë dialogun, si mënyrë për gjetjen e zgjidhjes për dallime në qëndrime. Gjithashtu, ky program ka edhe qëllimin që të krijojë një lloj kornize ku do të përfshiheshin të gjitha organizatat që merren me Evropën Juglindore, për bashkëpunim më të mirë dhe për finansimin më të lehtë të aktiviteteve të tyre.